

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Kontabiliteti Financiar

P1

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 24.09.2022

Problemi 1

Në vijim është Bilanci vërtetues i Grafikës S.B shpk më 30 qershor 2022:

Llogaritë	Debi	Kredi
Kapitali aksionar	-	21,000,000
Premia në aksione	-	5,000,000
Shitjet	-	134,840,000
Lejimet për borxhet e dyshimta	-	620,000
Llogaritë e pagueshme	-	15,490,000
6%Kredia afatgjatë	-	30,000,000
Fitimet e mbajtura	-	16,570,000
Të pagueshmet tjera (Akrualet)	-	1,250,000
Stoqet në fillim	20,730,000	-
Blerjet	99,540,000	-
Llogaritë e arkëtueshme	20,200,000	-
Shpenzimet e interesit	900,000	-
Parapagimet	618,000	-
Dividenta e ndërmjetme e paguar	4,500,000	-
Dividenta përfundimtare e paguar	3,000,000	-
Kthimet e shitjeve	456,000	-
Shpenzimet e shpërndarjes	12,800,000	-
Paraja e gatshme	1,930,000	-
Shpenzimet administrative	7,610,000	-
Toka-Kosto	35,900,000	-
Ndërtesa-Kosto	12,800,000	-
Impijantet e prodhimit-Kosto	6,950,000	-
Automjetet - Kosto	17,320,000	-
Mobiljet e zyres - Kosto	5,970,000	-
Kthimet e blerjeve	-	714,000
Zhvlerësimi i akumuluar - Ndërtesat	-	9,020,000
Zhvlerësimi i akumuluar - Impijantet e prodhimit	-	4,370,000
Zhvlerësimi i akumuluar - Automjetet	-	10,030,000
Zhvlerësimi i akumuluar - Mobiljet e zyrës	-	2,320,000
	251,224,000	251,224,000

Informata shtesë:

- Stoqet në fund janë 13,870,000 eur.
- Toka është rivlerësuar më 30 qershor 2022 nga vlerësuesi profesional në shumë prej 3,200,000 eur më shumë se sa që e kishte vlerën në libra .
- Shpenzimet e tatimit për vitin janë 5,190,000 eur, të cilat nuk janë paguar.
- Disa mallra të cilat janë shitur klientëve me afat në shumë prej 121,000 eur në maj 2022, me kosto të blerjes prej 72,000 eur, ishin kthyer nga klientët. Mirëpo nuk është bërë asnjë regjistrim për këtë kthim të mallrave.
- Kompania kishte bërë një kampanjë të marketingut për 4 muaj, duke filluar më 1 qershor 2022, e cila ka kushtuar 76,000 eur. Kjo shumë është përfshirë komplet si shpenzim i shpërndarjes.
- Shpenzimet e interesit për 6 muaj të vitit nuk janë përfshirë në Bilancin Vërtetues.

Kërkohet:

Përgatitni pasqyrat financiare sipas SNK 1 për vitin që përfundon më 30 qershor 2022.

- (i) Pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse
- (ii) Pasqyrën e pozicionit financiar

(20 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

Grafika SHB Pasqyra e të ardhurave për vitin që përfundon më 30 qershor 2022

		'000 €
Shitjet (134,840 - 456 - 121)		134,263
Minus KMSH	LL-01	<u>105,614</u>
Fitimi bruto		28,649
Minus: Shpenzimet e shpërndarjes	LL-02	(12,743)
Minus: Shpenzimet administrative		<u>(7,610)</u>
Fitimi operativ		8,296
Minus Shpenzimet e interesit (900 + 900)		<u>(1,800)</u>
Fitimi para tatimit		6,496
Shpenzimet e tatimit		<u>(5,190)</u>
Fitimi neto		<u>1,306</u>

Grafika SHB Pasqyra e pozicionit financiar më 30 qershor 2022

		'000 €
Pasuritë		
Pasuritë jo qarkulluese	LL-3	56,400
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet në fund (13,870 + 72)		13,942
Llogaritë e arkëtueshme neto (20,200 - 121 - 620)		19,459
Parapagimet (618 + 57)		675
Paraja e gatshme		1,930
Totali i pasurive qarkulluese		<u>36,006</u>
Totali i pasurive		92,406
Ekuiteti dhe Detyrimet		
EKUITETI		
Kapitali Aksionar		21,000
Premia në aksione		5,000
Rezerva e rivlerësimit		3,200
Fitimet e mbajtura (16,570 + 1,306 - 7,500)		10,376
Total Ekuiteti		39,576
Kredia afatgjatë		30,000
Detyrimet afatshkurtëra		
Llogaritë e pagueshme		15,490
Tatimi i pagueshëm		5,190
Të pagueshmet tjera (Akrualet) (1,250 + 900)		2,150
Totali i detyrimeve afatshkurtëra		22,830
TOTAL EKUITETI DHE DETYRIMET		<u>92,406</u>

LL1 (KMSH)

Stoqet në fillim	20,730
Plus Blerjet	99,540
Minus Kthimet e blerjeve	(714)
Minus kthimet e mallrave nga klientët	<u>(72)</u>
Minus Stoqet në fund	<u>(13,870)</u>
KMSH	<u>105,614</u>

LL2 Shpenzimet e shpërndarjes

Shpenzimet e shpërndarjes sipas BV	12,800
Minus Shpenzimet e marketingut për 3 muaj (76 X 3/4)	(57)
Total shpenzimet e shpërndarjes	<u>12,743</u>

LL3 (Pasuritë jo qarkulluese)

	Kosto	Zhyl i akumuluar	Rivlerësimi	Totali
Toka (35,900 + 3,200)	35,900	-	3,200	39,100
Ndërtesat	12,800	9,020	-	3,780
Impijantet e prodhimit	6,950	4,370	-	2,580
Automjetet	17,320	10,030	-	7,290
Mobiljet e zyrës	5,970	2,320	-	3,650
Vlera neto në libra më 30 qershor 2022	78,940	25,740	3,200	56,400

Problemi 2 - Pjesa a) dhe b) janë të ndara

a) Kompania Alfa ka politikë të kontabilitetit të vlerësojë stoqet me koston ose VNR cila prej tyre është më e ulët. Nga shitjet e bëra të paraqitura si në tabelën në vijim, 40% e tyre janë me afat kthimi. Shpenzimet për t`u realizuar shitjet janë 10% e shitjeve dhe shpenzimet e arkëtimit të borxheve të klientëve janë 1% e Llogarive të Arkëtueshme:

Produkti	Kosto(€)	Shitjet e pritura (€)
A	80,000	120,000
B	98,000	101,000
C	50,000	40,000
D	89,000	73,000
E	94,000	108,000
F	180,000	205,000
G	194,000	210,000

Kërkohet:

Përcaktoni vlerën e stoqeve më 31 dhjetor 2021.

(10 pikë)

b) Kompania Lisi shpk ka paraqitur ekstraktin nga Pasqyra e pozicionit financiar si në vijim më 31 dhjetor 2020 :

Eur	
Ekuiteti:	
Kapitali aksionar (Vlera nominale 0.25€ secili)	200,000
Premia në aksione	80,000
Rezerva e rivlerësimit	40,000
Fitimet e mbajtura	37,500
	357,500

Në vijim paraqiten informatat shtesë:

- Më 1 janar 2021 është bërë emetimi i të drejtave në bazën 2 aksione të zakonshme për çdo 5 që janë në dorë me çmim prej 0.40 € për aksion. Ky emetim i të drejtave është shfrytëzuar nga aksionarët.
- Më 30 qershor 2021 është deklaruar dividenda e ndërmjetme prej 0.04€ për aksion dhe është paguar për të gjitha aksionet në atë datë.
- Më 31 gusht 2021 janë rivlerësuar pasuritë jo qarkulluese me vlerë të tregut për 48,000 € më shumë se vlera në libra.
- Fitimi për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021 ishte 22,500 €.

Kërkohet:

Përgatitni Pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021. (10 pikë)

Zgjidhja-pjesa a)

Produkti	Kosto	Shitjet e pritura	Shpenzimet e shitjes 10% e shitjeve	VNR	Më e ulëta prej kostos ose VNR
A	80,000	120,000	12,000	108,000	80,000
B	98,000	101,000	10,100	90,900	90,900
C	50,000	40,000	4,000	36,000	36,000
D	89,000	73,000	7,300	65,700	65,700
E	94,000	108,000	10,800	97,200	94,000
F	180,000	205,000	20,500	184,500	180,000
G	194,000	210,000	21,000	189,000	189,000
TOTAL	785,000	857,000	85,700	771,300	735,600

b)

Lisi shpk

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020

	Kapitali aksionar	Premia në aksione	Rezerva e rivlerësimit	Fitimi i mbajtur
Saldo më 1 janar 2020	200,000	80,000	40,000	37,500
Emetimi i të drejtave	80,000 (1)	48,000 (1)	-	-
Dividentat				(44,800) (2)
Rivlerësimi			48,000 (3)	
Fitimi neto i vitit				22,500 (4)
Saldo më 31 dhjetor 2020	<u>280,000</u>	<u>128,000</u>	<u>88,000</u>	<u>15,200</u>

1) Emetimi i të drejtave:

800,000 aksione janë aktualisht në zotërim*0.25=200,000 eur

800,000 aksione*2/5=320,000 aksione të emetuara shtesë

VN e 320,000 aksioneve=320,000*0.25=80,000 eur

Vlera e emetimit e 320,000 aksioneve=320,000*0.40=128,000 eur

Regjistrimi:

Debi Paraja e gatshme 128,000

 Kredi Aksionet e zakonshme 80,000

 Kredi Premia në aksione 48,000

2) Dividenta e deklaruar=0.04*(800,000aks+320,000aks)=0.04*1,120,000=44,800

Problemi 3

Kompania Etna ka këto Pasqyra të pozitës financiare për vitet 2020 dhe 2021:

	2021	2020
	€	€
Pasuritë		
Pasuritë jo qarkulluese		
Toka dhe ndërtesa	380,000	400,000
Makineritë	920,000	750,000
Investimet afatgjata	50,000	100,000
Pasuritë qarkulluese		
Stoqet	280,000	300,000
Llogaritë e arkëtueshme	420,000	400,000
Paraja e gatshme në dorë	140,000	200,000
Paraja e gatshme në bankë	410,000	300,000
Total pasuritë	<u>2,600,000</u>	<u>2,450,000</u>
Ekuiteti	€	€
Kapitali aksionar (Vlera nominale 10 eur)	1,250,000	1,000,000
Premia në aksione	10,000	-
Fitimi i mbajtur	480,000	400,000
Detyrimet		
Kredia afatgjatë	400,000	500,000
Detyrimet afatshkurta	400,000	500,000
Tatimi i pagueshëm	60,000	50,000
Totali i Ekuitetit dhe Detyrimeve	2,600,000	2,450,000

Shënimet shtesë lidhur me vitin 2021 janë si në vijim:

- Shpenzimet e zhvlerësimit për ndërtesën janë 20,000€, shpenzimet e zhvlerësimit për makineritë duhet të gjinden.
- Fitimi para tatimit është 135,000 €
- Kompania ka shitur investimet afatgjata me fitim prej 10,000 €.
- Shpenzimet e tatimit për vitin janë 55,000€.
- Kompania ka blerë makineri gjatë vitit për 225,000€. Ka paguar në para shumën prej 125,000€ dhe pjesën tjetër ka emetuar 10,000 aksione me vlerë nominale 10 eur.

Kërkohet:

Përgatitni Pasqyrën e rrjedhave të arkës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021, sipas kërkesave të SNK 7, duke përdorur metodën indirekte.

(20 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

Kompania Etna **Pasqyra e rrjedhave të arkës për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021**

		Eur	
Aktivitetet operative			
Fitimi para tatimit			135,000
Korrigjimet për :			
Shpenzimet e zhvlerësimit-makineritë	LL-3	55,000	
Shpenzimet e zhvlerësimit - Ndërtesat		<u>20,000</u>	75,000
Fitimi kapital nga shitja e investimeve			<u>(10,000)</u>
Zvogëlimi në stoqe		20,000	
Rritja në LL/A		(20,000)	
Zvogëlimi në Detyrimet afatshkurta		<u>(100,000)</u>	<u>(100,000)</u>
Tatimi i paguar		LL-1	<u>(45,000)</u>
Rrjedha neto e parasë nga Aktivitetet operative			55,000
Aktivitetet investuese			
Blerja e makinerisë			(125,000)
Shitja e investimeve afatgjata	LL-2	<u>60,000</u>	
Rrjedha neto e parasë nga Aktivitetet investuese			<u>(65,000)</u>
Aktivitetet financuese			
Emetimi i aksioneve (250,000 diferenca-100,000 këmbimi me pasuri+10,000 premia)			160,000
Pagimi i kredisë afatgjatë			<u>(100,000)</u>
Rrjedha neto e parasë nga Aktivitetet financuese			60,000
Saldo në fillim e parsë dhe ekuivalentëve (200,000 +300,000)			<u>500,000</u>
Rrjedha neto e parasë gjatë vitit (55,000-65,000+60,000)			50,000
Saldo në fund e parsë dhe ekuivalentëve (140,000 +410,000)			550,000

Llogaritjet

LL1 - Tatimi i paguar gjatë vitit	Eur
Shpenzimet e tatimit për vitin	55,000
Plus Saldo në fillim e tatimit të pagueshëm	<u>50,000</u>
	105,000
Minus Saldo në fund e tatimit të pagueshëm	<u>60,000</u>
Tatimi i paguar gjatë vitit	45,000
LL2 - Paraja e gatshme nga shitja e investimeve afatgjata	
Saldo në fillim e investimeve	100,000
Plus fitimi kapital	<u>10,000</u>
	110,000
Minus Saldo në fund e investimeve	<u>50,000</u>
Paraja e gatshme nga shitja e investimeve afatgjata	60,000
LL3 - Shpenzimet e zhvlerësimit për makineritë	
VNL e Makinerive saldo në fillim	750,000
Plus makineritë e blera gjatë vitit	<u>225,000</u>
	975,000
Minus saldo në fund e makinerive	<u>920,000</u>
Shpenzimet e zhvlerësimit për makineritë	55,000

Regjistrimi i blerjes së makinerisë:

D Makineritë (kosto) 225,000

K Paraja e gatshme 125,000

K Kapitali aksionar 100,000

Problemi 4

Drafti i pasqyrave financiare të Ana shpk, kompani me përgjegjësi të kufizuara, për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021 tregoi një fitim prej 86,000 €. Bilanci vërtetues nuk u barazua dhe përfshin një llogari pezull prej 3,310 € në kredi.

Gjatë kontrollimeve të mëposhme, u gjetën gabimet në vijim:

- (a) Zhvlerësimi i mjeteve motorike për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021 prej 25 % është llogaritur me metodën e saldove zbritëse dhe është dashur të kalkulohet sipas metodës drejtvizore gjithashtu 25% . Shifrat përkatëse:
Kosto e mjeteve motorike 120,000 €, vlera neto në libra më 1 Janar 2021, 88,000 €.
- (b) Qiraja e pranuar nga palët e treta për akomodim në zyre prej 1,200 €, ishte vënë në arkën e parave të vogla. Nuk u regjistrua as qeraja e arkëtueshme kur u arkëtua qiraja dhe nuk kishte pasur hyrje në librin e parave të vogla apo diku tjetër për të. Llogaria e arkës së parave të vogla në bilancin vërtetues sipas regjistrimeve të bëra tregon shumën prej 1,200 € më pak se sa shuma aktuale e parave e cila ndodhet realisht në arkë.
- (c) Borxhet e paarkëtueshme prej 8,400 € duhet të fshihen plotësisht.
- (d) Saldo në fillim e llogarisë akruale për riparimet e mjeteve motorike të pagueshme prej 3,400 €, përfaqëson faturat e riparimit të pranuar por jo të paguara më 31 dhjetor 2020 dhe kjo saldo nuk ishte bartur më 1 Janar 2021.
- (e) Shuma e zbritjeve në para të gatshme për dhjetor 2021 nuk u postuan në llogaritë e zbritjeve në librin kryesor.

Shifrat ishin :

	€
Zbritja e lejuar	380
Zbritja e marrë	290

Pas korrigjimeve të nevojshme, llogaria pezull u balancua.

Kërkohet

Përgatisni hyrjet në ditar me shënimet përkatëse, për të korrigjuar gabimet e gjetura, përgatisni një pasqyrë ku tregoni ndryshimet të cilat kanë efekt në fitimin e vitit dhe përgatitni llogarinë pezull.

20 pikë

Zgjidhja e problemit 4

Hyrjet në ditar

	<i>Debi</i>	<i>Kredi</i>
	€	€
(a) Shpenzimet e zhvlerësimit - mjetet motorike (Ll) Zhvlerësimi i akumuluar - mjetet motorike	8,000	8,000
(b) Paratë e vogla Qiraja e arkëtueshme	1,200	1,200
(c) Shpenzimet e borxheve të qjija Llogaria kontrolluese e të arkëtueshmeve	8,400	8,400
(d) Llogaria pezull Te pagueshmet për riparimet e mjeteve motorike	3,400	3,400
(e) Zbritja e lejuar Zbritja e marrë Llogaria pezull	380	290 90

Korrigjimi i fitimit

Fitimi i pakorrigjuar	86,000
Zhvlerësimi	(8,000)
Borxhi i keq i shlyer	(8,400)
Zbritjet e lejuara	(380)
Zbritjet e marra	290
Fitimi neto i korrigjuar	<u>69,510</u>

LLOGARIA PEZULL

Riparimet e mjeteve motorike	€ 3,400	Saldo në fillim	€ 3,310
		Zbritjet	90
	<u>3,400</u>		<u>3,400</u>

Llogaritjet

Korrigjimi i zhvlerësimit

Sipas saldove zbritëse (88 x 25%)	22,000
Metoda drejtëvizore (120 x 25%)	30,000
Zhvlerësimi shtesë	<u>8,000</u>

Problemi 5

Kontabilisti i kompanisë Odeta shpk, ka kërkuar që ju si këshilltar t'i përgatitni disa informata në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme. Kompania ju ka ofruar informatat si në vijim:

(i) Saldo fillestare në llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme ishte si në vijim:

Llogaritë e arkëtueshme:	Debi	€56,247
Llogaritë e pagueshme:	Kredi	€68,164

(ii) Në vijim janë transaksionet të cilat kanë ndodhur për vitin i cili përfundon më 31 dhjetor 2021 në lidhje me llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme:

	€
Shitjet me afat/kredi	345,812
Shitjet me para të gatshme	10,845
Blerjet me afat/kredi	220,541
Kthimet e shitjeve me afat/kredi	6,475
Kthimet e blerjeve me afat/kredi	20,169
Kontra hyrjet	15,467
Zbritjet e lejuara	14,852
Zbritjet e marra	23,253
Shumat e paguara në para të gatshme për llogaritë e pagueshme	194,652
Shumat e arkëtuara në para të gatshme nga llogaritë e arkëtueshme	362,145
Borxhet e këqija	1,571
Lejimet për borxhet e dyshimta	1,854

Kërkohet:

(a) Përgatitni Llogarinë Kontrolluese të të Arkëtueshmeve dhe Llogarinë Kontrolluese të të Pagueshmeve, për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021,

(8 pikë)

(b) Përgatitni hyrjet në ditar për të gjitha transaksionet nën (ii) si më lartë, duke supozuar se asnjë transaksion nuk është regjistruar deri më tani.

(12 pikë)

(Totali: 20 Pikë)

a) Debi	Llogaria kontrolluese e të pagueshmeve €	Kredi €
	Saldo në fillim	
Kthimet e blerjeve	20,169	Blerjet me kredi 68,164
Kontrahyrjet	15,467	220,541
Zbritjet e marra	23,253	
Paraja e gatshme	194,652	
Saldo balancuese	<u>35,164</u>	-
	<u>288,705</u>	<u>288,705</u>
	Saldo përfundimtare	
Debi	Llogaria kontrolluese e të arkëtueshmeve €	Kredi €
Saldo në fillim	56,247	€
Shitjet me kredi	345,812	Kthimet e shitjeve 6,475
		Kundërrhyrjet 15,467
		Zbritjet e lejuara 14,852
		Paraja e gatshme 362,145
		Borxhet e këqija 1,571
		Saldo balancuese 1,549
	<u>402,059</u>	<u>402,059</u>
Saldo përfundimtare	1,549	

Shënim: Shitjet me para të gatshme nuk përfshihen në LL/A, Lejimet për borxhet e dyshimta janë konto e ndarë e cila paraqitet në B/Gj.

b)			
D.	LL/ A	345,812	
K.	Të hyrat nga shitja		345,812
D.	Paraja e gatshme	10,845	
K.	Të hyrat nga shitja		10,845
D.	Blerjet	220,541	
K.	LL/P		220,541
D.	Kthimet e shitjeve	6,475	
K.	LL/ A		6,475
D.	LL/P	20,169	
K.	Kthimet e blerjeve		20,169
D.	LL/P	15,467	
K.	LL/ A		15,467
D.	Zbritjet e lejuara	14,852	
K.	LL/ A		14,852
D.	LL/P	23,253	
K.	Zbritjet e marra		23,253

D.	LL/P	194,652	
K.	Paraja e gatshme		194,652
D.	Paraja e gatshme	362,145	
K.	LL/A		362,145
D.	Shpenzimet e borxheve të këqija	1,571	
K.	LL/A		1,571
D.	Shpenzimet e borxheve të dyshimta	1,854	
K.	Lejimet për borxhet e dyshimta		1,854
